

URDHËR
Nr. 59, datë 1.2.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit për ndjekjen e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve për ndarjen e fondit “Grant/transfertë korrente e brendshme”, për çdo organizatë sportive aplikuese, në përputhje me formulën e financimit të parashikuar në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 25.2.2022, “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grant/transfertë korrentë e brendshme” për federatat sportive olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping”.

2. Kompetencat e deleguara ushtrohen deri në përfundimin e procedurës sipas pikës 1, të këtij urdhri, për vitin 2023.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi